



REPUBLIKA E SHQIPËRISE

AKADEMIA E STUDIMEVE ALBANOLOGJIKE  
KOMISIONI ZGJEDHOR INSTITUCIONAL  
INSTITUTI I GJUHËSISË DHE I LETËRSISË

Nr. 16 Prot

Tiranë më, 08/07/2021

VENDIM

Bazuar në ligjin nr. 8485, dt. 12.05. 1999 “Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar dhe nenit 131 të ligjit nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, urdhrin e Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë Nr. 173, datë 22.06.2021 “Për procesin zgjedhor për autoritetet dhe organet drejtuese në institucionet publike të arsimit të lartë”, urdhrin e Rektorit të Akademisë së Studimeve Albanologjike Nr. 223/1 Prot, datë 24.06.2021, dhe të Rregullores “Për organizimin e zgjedhjeve për autoritetet drejtuese dhe Senatit Akademik në Akademinë e Studimeve Albanologjike”, Komisioni Zgjedhor Institucional i Institutit të Gjuhësisë dhe të Letërsisë, pasi shqyrtoi dosjet e kandidaturave të paraqitura për përgjegjës departamenti në mbledhjen e datës 08.07.2021:

VENDOSI

Miratimin e kandidaturave të paraqitura nga:

1. **VALTER MEMISHA** - për përgjegjës të Departamentit të Leksikologjisë, terminologjisë dhe gjuhësisë së zbatuar
2. **ADELINA ÇERPJA** - për përgjegjës të Departamentit të Gramatikës dhe historisë së gjuhës
3. **IVALDA PACI** - për përgjegjëse të Departamentit të Studimeve letrare

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

Merita Bruçi

ANËTARË:

Anila Kananaj



Valbona Sinanaj

SEKRETARE

Engjëllushe Karaj